



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Bujar Lushaku	13.02.2023	22.02.2023	2023/0068

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 08.02.2023, OE “N.T.P.GRESA - COMMERCE ”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0068, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “N.T.P.GRESA - COMMERCE ”- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me pelet Ri-tender” me nr. të prokurimit: "651-22-12392-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, negociuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: xx,xxx €. Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0068 i dt:08.02.2023. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Ankues: OE “NTP Gresa Commerc” - Prizren

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues: OP “NTP Gresa Commerc” - Prizren janë:

Nenin 1-Qëllimi, i drejtë i shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe gjitha fondeve dhe burimeve publike të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Nenin 6- i LPP-së

Nenin 7- Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Nenin 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Nenin 60- i LPP-së

Nenin 72- i LPP-së

Nenin 62- i LPP-së

Nenin 43.5 i Rregullores Nr.001/202 për Prokurim Publik

Nenin 43.7 i Rregullores Nr.001/202 për Prokurim Publik

Me datë 25.11.2022 përmes platformës elektronike E-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e Ak-se ,ku e ka anuluar aktivitetin e prokurimit ,me arsyetimin se nuk ka as një oferte të përgjegjshme ,ndërsa neve na ka eliminuar me arsyetim se :

Autoriteti kontraktues –Kuvendi Komunal Gjilan-

Komisioni i vlerësimit pas ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave ka konstatuar se OE n.t.p Gresa Commerc në dosje të tenderit dhe në njoftim për kontratë është kërkuar që të:

Kërkesa 2. Operatori Ekonomik duhet të posedoj mjete të punës në dispozicion për realizimin e furnizimeve, min 1 kamion

Dëshmia 2. Dokument valide për qarkullim dhe e lexueshme kopja, marrëveshje për huazim apo kontratë ose dëd doganor

Komisioni ka verifikuar se për kërkesën nr 2 ju mungon dëshmia e kërkuar dokumenti valide për qarkullim dhe e lexueshme kopja, marrëveshje për huazim apo kontratë ose dëd doganor .

Sa i përke arsyetimit të lartcekur për eliminimin e kompanisë tonë, ku AK-ja e ka cekur se neve na mungojnë dëshmitë e kërkuara për kërkesën nr. 2, ju sqarojmë se ky arsyetim është i paqëndrueshëm.

Në lidhje me komisionin e lartcekur , ju sqarojmë se ne e posedojmë të njëjtën pajisje ku e njëjta ka afat valid të regjistrimit , mirëpo që gjatë ofrimit nga ana jon ka ndodhur një lëshim teknik, ku nuk është bashkangjitur librezja me afat valid, të cilës i figuron data e regjistrimit para datës së hapjes së ofertave.

Autoriteti kontraktues edhe për kundër faktit të lartcekur (se nuk ka qen e bashkangjitur librezja e kamionit)është dashur të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 ku është përcaktuar qartë

2.Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkoj nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilën do nga aspektet e tenderit të tije, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve".

Gjithashtu faktin se është dashur të kërkohej sqarime shtesë në lidhje me kamionin e lartcekur, e parasheh edhe neni 72.2 ku shkruan se " 2.Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Ndërsa tek neni 72.3 të LPP-se, përcaktohet qartë "3.Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Në e posedojmë librezën e regjistrimit të kamionit të kontestuar nga AK-ja, i cili ka afat valid të regjistrimit dhe është i regjistruar për hapjes së ofertave. Kur analizohet librezja të cilën po ju bashkangjesim shihet se validiteti i regjistrimit është vazhduar nga data e skadimit dhe nga ky fakt kuptohet qartë se në e përmbushim kërkesën e dosjes së tenderit dhe arsyeja e AK-së për eliminimin tone është e pa bazuar dhe e paqëndrueshme. (Sa për korrektësi, bashkangjitur kemi librezën me afat valid të regjistrimit).

Duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë se në e përmbushim kërkesën në lidhje me pajisjet dhe se arsyeja e AK-së për eliminimin tone është vetëm një pretekst, pa ndonjë arsyetim konkret, pasi që na ka eliminuar pa kërkuar sqarime shtesë fare.

Në më 01.02.2023 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK-së ku e njëjta e ka cilsuar kërkesën tonë për rishqyrtim si të pa bazuar me arsyetimin si në vijim:

Autoriteti kontraktues (AK) në harmoni me nenin 59 të LPP-së, ka bërë egzaminimin vlerësimin e ofertave, dhe sipas kriterëve të përcaktuara në FDT dhe njoftimin për kontratë. Gjatë kësaj faze AK-ja ka kërkuar sqarim shtesë nga ana juaj më 21.11.2022 përmes letrës standarte. Sqaruesi lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional më saktësisht për kërkesën nr, sipas DT dhe njoftimit për kontratë:

Kërkesa nr 2 operatori ekonomik duhet të posedojë mjete të punës në disporcion për realizimin e furnizimeve, min, 1 kamion

Dëshmia e kërkuar:

Dëshmia 2. Dokument valide për qarkullim dhe e lexueshme kopja, marrëveshje për huazim apo kontratë ose dëd doganor

Afati kohor për përgjigjeje tuaj lidhur me këtë qështje ka qen deri me dt 23.11.2022 në ora 1200h

Pasiqe nga ana juajë nuk është konfirmuar dhe nuk jeni përgjigjur rreth pyetjes së AK-së AK ka konsideruar se ju nuk shprehni interesim për te vazhduar më tutje .

Andaj,AK gjat fazës se rivlerësimit ka konsideruar se është tejkaluar vlera e parashikuar e kontratës ,andaj duke u bazuar edhe ne emailin e dërguar te ju si OE i interesuar ne këtë procedurë me date 21.11.2022 dhe mos përgjigjes tuaj ne kërkesën e AK ne afatin e caktuar qe nënkupton mos interesimin tuaj për të vazhduar më tutje . te prokurimit ka tejkaluar vlerën e parashikuar ,andaj AK merr vendim që të anulojë këtë aktivitet .

Nga njësia kërkuese është konfirmuar se nuk ka mjete të mjaftueshme për të vazhduar më tutje .

Duke parë pretendimet tuaja ankimore ne kemi shqyrtuar në detaje këto te fundit .

Ashtu siq jeni të njoftuar përmes platformes elektronike permes njoftimit mbi vendimin e AK-se dhe letres stsndarte të dates 24.01.2023AK-kuvendi komunal Gjilan ka ber anulimin e kesaj procedure te prokurimit pasi qe ka konstatuar se oferta e dorzuar nga ana e OE te interesuar ne kete procedur te prokurimit ka tejkaluar vleren e parashikuar.Andaj AK mer vendim qe te anuloj ket aktivitet.

Nga njesia kerkuse është konfirmuar se nuk ka mjete te mjaftuesht per te vazhduar me tutje .Duke par pretendimet tuaja ankimore ne si AK kemi shqyrtuar ne detaj keto te fundit.

Konstatimi i lartcekur i autoritetit kontraktues është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm për faktin se kjo lëndë është kthyer në rivlerësim, ndërsa kuptohet se rivlerësimi nënkupton pikën zero. Pas rivlerësimit, neve AK-ja nuk na ka kërkuar sqarime shtesë edhe pse lënda është kthyer në rivlerësim, pra në pikën zero që do të thotë se rivlerësimi i ofertave duhet të bëhet edhe një herë.

Duhet cekur fakti se herën e parë para rivlerësimit neve na janë kërkuar sqarime shtesë, mirëpo që ne nuk i kemi kthyer përgjigjet për shkak se kemi pasur probleme në email dhe në e prokurim ku nuk e kemi pranuar fare kërkesën për sqarime dhe për këtë fakt nuk kemi mundur të i kthejmë përgjigjet.

Mirëpo edhe përkundër këtij fakti duke pasur parasysh qe rivlerësimi është pika zero atëherë kuptohet qartë se ne kemi të drejtën e plotë të ankesës, mirëpo autoriteti kontraktues me qëllim të eliminimit tonë po i referohet faktit se kinse na ka kërkuar sqarime shtesë në herën e parë dhe se ne nuk i kemi kthyer përgjigjeje.

Përderisa lënda është kthyer në rivlerësim AK-ja është dashur të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe

72 të LPP-së pasi që siç e cekëm lënda është kthyer në pikën zero dhe gjithashtu libreza dhe regjistrimi i një makinerie vërtetohet qartë në momentin që prezantohet dëshmia-libreza, se a ka qenë apo jo i regjistruar kamioni në këtë rast.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i pa qëndrueshëm dhe i pa mbështetur në dispozita konkrete ligjore.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Gjithashtu ky anulim i këtij aktivitet të prokurimit është bërë në kundërshtim edhe me nenet 43.5 dhe 43.7 të Rregullores nr.001/2022 Për Prokurim Publik, sepse asnjëri nga kushtet e parashikuara në këto dispozita nuk janë përmbushur në këtë rast dhe nuk ka asnjë mundësi ligjore që ky aktivitet i prokurimit të anulohet në këtë fazë.

Njëkohësisht AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse na ka diskriminuar neve duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë dhe gjithë ashtu jemi OE me çmim më të lirë. Paragrafi i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

AK është dashur të ketë në konsideratë edhe nenin I të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të lëshojë:

VEN DIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE N.T.P. " Gresa - Commerc si dhe të

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në RIVLERËSIM,

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kerkesa 2. Operatori Ekonomik duhet të posedoj mjete të punës në dispozicion për realizimin e furnizimeve, min 1 kamion

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Deshmia 2. Dokument valide për qarkullim dhe e lexueshme kopja, marrëveshje për huazim apo kontrate ose dud doganor.

Buxheti i planifikuar – (Të gjithë ofertuesit tejkalojn buxhetin e paraparë)

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Komisioni i Vlersimit ka rekomanduar zyrtarin përgjegjës të Prokurimit që të anulohej aktivitetin e prokurimit për arsye se ka pas tejkalim të buxhetit që është paraparë në Njoftim për Kontratë dhe në Dosje të Tenderitë.

Ndersa me datën 24.01.2023 Zyrtarja Përgjegjëse e Prokurimit e AK- ka marr vendim që në bazë të raportit të vlersimit të publikoj njoftimin mbi vendimin e AK dhe të anuloj aktivitetin e prokurimit, në munges të operatorve të përgjegjshëm.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Nuk Aplikohen

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

OE ankues është palë me interes

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi i OSHP-se me nr 745/22 i datës 10.01.2023

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - N.T.P."GRESA - COMMERCE "

Duke u mbështetur në ekzaminimin e lëndës, konstatojmë si në vijimë:

Përgjigje në Pretendimi nr.1 .

OE"NTP Gresa Commerc"- Prizren - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Gjilan nuk e ka respektuar nenin 1 të LPP-së ,

Eksperi thekson se ndër tjera qellim i ketij neni është te sigurojn menyre ma efikase ,me transparente dhe më të drejtë të shfrytzimit të fondeve publike ,duke përcaktuar kushtet rregullat qe do te zbatohen , procedurat që do te ndiqen ,te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen, andaj trajtimi i OE,ankues si OE i eliminuar është në harmoni me nenin 1 të LPP-së .

AK e ka eliminuar nga gara OE ankues duke sqaruar se nuk ka arritur ta ngarkojë në platformen e e-prokurimit „*Deshmia 2. Dokument valide per qarkullim dhe e lexueshme kopja, marrëveshje për huazim apo kontrate ose dud doganor*”siq ua ka kerkuar me datë 21.11.2022duke ju jep afat deri me daten 23.11.2022.

OE ankues pretendon se ka pasur probleme në platformen e e-prokurimit ,dhe nuk e ka ngarkuar ne platform dokumentin e kerkuarë.

Eksporti konstaton se sqarimet e kerkuara nga AK gjat fazes së vlerësimit OE ankues nuk ka arritur ti sjell dhe i njeiti me të drejtë është eliminuar ,andaj nuk qendron pretendimi i OE ankues .

Andaj,

Eksporti konstaton se ky pretendim është i pa bazuarë

Përgjigje në Pretendimi nr.2 .

OE"NTP Gresa Commerc"- Prizren - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Gjilan nuk e ka respektuar nenin 6 të LPP-së ,

Eksporti thekson se nder të tjera qellim i ketij neni është te siguroj qe fondet publike dhe burimet publike te perdoren ne menyre me ekonomike ,duke e marr ne konsiderat qellimin dhe lenden e prokurimit, andaj trajtimi OE.ankues si i eliminuar është në harmoni me nenin 6 të LPP-së

Eksporti konstaton se eliminimi i OE ankues që nuk ka plotësuar te gjitha kriteret e parapara me NJ.K. dhe D.T. dhe që ka çmim më të lart se sa buxheti i planifikuar është në harmoni me nenin 6 të LPP-së

Andaj,

Eksperti konstaton se ky pretendim është i pa bazuarë

Përgjigje në Pretendimi nr.3 .

OE"NTP Gresa Commerc"- Prizren - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Gjilan nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së ,

Eksperti thekson se ndër të tjera qellim i këtij neni është që autoritetet kontraktuese duhet ti trajtojë të gjithë operatorët ekonomik në menyrë të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit .

Pretendimi i OE ankues ndër tjera lidhur me shkeljen e këtij neni: AK na ka diskriminuar neve se i kemi plotsuar te gjitha kërkesat e FDT-së dhe te NJK dhe gjithashtu jemi OE me çmim më të lirë

Eksperti sqaron se sa i perket pretendimit të OE ankues ,i njeiti pretendim nuk qendron sepse gjatë ekzaminimit të aktivitetit të prokurimit shihet se nuk ka pasur shkelje në dëm të OE ankues , si në trajtim jo të drejtë ,sepse sikurse e sqarova në pretendimin nr 1 OE ankues nuk ka arritur ti plotësojë te gjitha kriteret e parapara me NJK dhe DT dhe është eliminuar perveq kesaj OE ankues ka ofertuar me çmim ma të lart se sa buxheti i planifikuar.

Andaj,

Eksperti konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

Përgjigje në Pretendimi nr.4 .

OE"NTP Gresa Commerc"- Prizren - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Gjilan nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së ,

Eksperti thekson se qellim i këtij neni është Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve ,fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të Vlerësimit ,pasi ka pranuar kërkesën për rishqyrtim dhe lëndën e ka kthyer në rivlerësim ka themeluar komision për Rivlerësim .

Shih pretendim ankimor të OE ankues :

Ashtu siq jeni të njoftuar përmes platformes elektronike permes njoftimit mbi vendimin e AK-se dhe letres stndarte të dates 24.01.2023AK-kuvendi komunal Gjilan ka ber anulimin e kesaj procedure te prokurimit pasi qe ka konstatuar se oferta e dorzuar nga ana e OE te interesuar ne kete procedur te prokurimit ka tejkaluar vleren e parashikuar.Andaj AK mer vendim qe te anuloj ket aktivitet.

Nga njesia kerkuse eshte konfirmuar se nuk ka mjete te mjaftuesht per te vazhduar me tutje .Duke par pretendimet tuaja ankimore ne si AK kemi shqyrtuar ne detaj keto te fundit.

Konstatimi i lartcekur i autoritetit kontraktues është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm për faktin se kjo lëndë është kthyer në rivlerësim, ndërsa kuptohet se rivlerësimi nënkupton pikën zero. Pas rivlerësimit, neve AK-ja nuk na ka kërkuar sqarime shtesë edhe pse lënda është kthyer në rivlerësim, pra në pikën

zero që do të thotë se rivlerësimi i ofertave duhet të bëhet edhe një herë.

Duhet cekur fakti se herën e parë para rivlerësimit neve na janë kërkuar sqarime shtesë, mirëpo që ne nuk i kemi kthyer përgjigjet për shkak se kemi pasur probleme në email dhe në e prokurim ku nuk e kemi pranuar fare kërkesën për sqarime dhe për këtë fakt nuk kemi mundur të i kthejmë përgjigjet.

Mirëpo edhe përkundër këtij fakti duke pasur parasysh që rivlerësimi është pika zero atëherë kuptohet qartë se ne kemi të drejtën e plotë të ankesës, mirëpo autoriteti kontraktues me qëllim të eliminimit tonë po i referohet faktit se kinse na ka kërkuar sqarime shtesë në herën e parë dhe se ne nuk i kemi kthyer përgjigje.

Eksperti sqaron se AK me të drejt ka konstatuar se të gjitha ofertat e tejkalojnë buxhetin e planifikuar dhe ne harmoni me nenin 59 të LPP e ka anuluar aktivitetin e prokurimit sepse buxheti i planifikuar ishte 106.750.00€ ndersa oferta e OE ankues ishte me çmim prej: 178,980.00 e që do të thot se ishte ofert me vlerë 72,230.00€ ma e lart se buxheti i planifikuar, andaj sqarimet per te cilat pretendon OE ankues se nuk ju kanë kërkuar me rastin e rivlerësimit nuk ishin të nevojshme për AK sepse te njejtat nuk do të kishin ndikim në

rezultatit perfundimtar ,sepse siq e sqarova më lart ishte dallim i lart ne mes ofertës së OE ankues dhe buxhetit të paraparë

Andaj,

Eksperti konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

Përgjigje në Pretendimi nr.5 .

OE"NTP Gresa Commerc"- Prizren - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Gjilan nuk e ka respektuar nenin 60 të LPP-së ,

Eksperti thekson se qellim i ketij neni është vendosja e kritert per dhenje të kontrates,ku kriter ishte tenderi i pergjegjeshëm me çmim më te ulët .

OE ankues vetem siperfaqsisht e ka permendur këtë nenë pa e specifikuar se qka nuk ishte ne harmoni me këtë nenë por me një vend e permend se është ofertues i pergjegjeshem dhe ka dorzuar ofertë me çmim më te lirë dhe nuk është shpallur fitues ,

I njejt pretendim nuk qendron shih sqarimin ne pretendimin numer 4 të kesaj ekspertize.

Andaj,

Eksperti konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

Përgjigje në Pretendimi nr.6 .

OE"NTP Gresa Commerc"- Prizren - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Gjilan nuk e ka respektuar nenin 72 të LPP-së ,

OE ankues pretendon se : Përderisa lënda është kthyer në rivlerësim AK-ja është dashur të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së pasi që siç e cekëm lënda është kthyer në pikën zero dhe gjithashtu librezat dhe regjistrimi i një makinerie vërtetohet qartë në momentin që

prezantohet dëshmia-libreza, se a ka qenë apo jo i regjistruar kamioni në këtë rast.

Eksperti sqaron se nuk qendron pretendimi i OE ankues sepse me rastin e rivlerësimit ka mundur të kërkojë sqarime dhe të sqarohet pika kontestuese sa i përket Librezes së Kamionit mirëpo AK në fazën e rivlerësimit nuk e ka konsiderua të arsyeshme me kërkuar përsëri sqarime, sqarimi i ngritur si pretendim nuk do kishte ndikim në rezultatin përfundimtar siq është sqaruar në pretendimin nr 4..

Andaj,

Eksperti konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

Përgjigje në Pretendimi nr.7 ,8 dhe 9.

OE"NTP Gresa Commerc"- Prizren - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Gjilan nuk e ka respektuar nenin 62 të LPP-së ,dhe nenin 43.5 dhe 43.7 i Rregullores Nr.001/202 për Prokurim Publik

Eksperti sqaron se neni 62 na sqaron se në cilat raste mund të përfundojë një aktivitet i prokurimit i cili nuk rezulton me dhenjeje të kontratës ,gjithashtu edhe neni 43.5 i rregullores se cekur më lart sqaron se kur përfundon një aktivitet i prokurimit pas hapjes së ofertave kur mund të anulohet për cilat arsye dhe neni 43.7 i rregullores sqaron se procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e më poshteme si : Të gjithë tenderet e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK-së .

Eksperti konstaton se kemi të bëjmë me rastin ku të gjithë tenderet përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK-së .dhe mbi këtë bazë AK me të drejtë e ka anuluar aktivitetin e prokurimit .

Andaj,

Eksperti konstaton se këto pretendime janë të pa bazuara .

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.T.P."GRESA - COMMERCE "", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pelet Ri- tender" me numër të prokurimit: "651-22-12392-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – N.T.P."GRESA - COMMERCE "

Bujar Lushaku

